

# AKT THEMELIMI STATUT I SHOQËRISË

“Proservis” sh.p.k.

---

## KREU I

### DATA E THEMELIMIT EMËRTIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, ZYRA QËNDRORE, FORMA E SHOQËRISË

#### Neni 1

##### Data e themelimit, Emërtimi dhe Themeluesi I vetëm

1.1 Sot më datë 29/03/2024 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Proservis”.

1.2 Themeluesi I vetëm I shoqërisë është:

**Monika Majko** atësia Rasim, e lindur më datë 21/12/1972, me zotesi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtese e letërnjoftimit me nr. 036870648 dhe me nr. Personal H26221076W.

#### Neni 2

##### Personalitet juridik

2.1 Shoqëria është person juridik shqiptar.

2.2 Shoqëria gëzon të drejta si person juridik shqiptar, që prej datës në të cilën kryhet regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### Neni 3

##### Forma e shoqërisë

3.1 Shoqëria do të ketë formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, derisa me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të vetëm) të vendoset shndërrimi i formës ligjore.

#### Neni 4

##### Objekti

4.1. Shoqëria Proservis sh.p.k. do të ketë si objekt të veprimtarisë:

4.1.1 Tregtim me pakicë pajisje profesionale dhe pajisje elektro shtëpiake për hoteleri, pastrime kimike, restorante, lavanderi, të reja dhe të përdorura.



1

# AKT THEMELIMI STATUT I SHOQËRISË

“Proservis” sh.p.k.

---

## Neni 5

### Kohëzgjatja

- 5.1 Shoqëria “Proservis” do të kryej veprimtarinë e saj tregtare për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe derisa të vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme (Ortakut të vetëm).

## Neni 6

### Selia

- 6.1 Selia kryesore e shoqërisë do të jetë në *Tiranë, Rruga “Teodor Keko”, Ndërtesa 055, Njësia Administrative 6*. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të vetëm) selia e shoqërisë mund të ndryshohet, hapen degë dhe zyra përfaqësimi të saj brenda dhe jashtë Shqipërisë.

## KREU II

### KAPITALI I REGJISTRUAR


## Neni 7

### Kapitali Themeltar

- 7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100.000 (njëqind mijë) Lekë, i 1 (një) kuote. Kapitali i shoqërisë nënshkruhet dhe paguhet nga ortaku I vetëm që zotëron 100% të kontributeve të kapitalit si vijon:

**Monika Majko**, atësia Rasim, e lindur më datë 21/12/1972, me zotesi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtese e letërnjoftimit me nr. 036870648 dhe me nr. Personal H 2 6 2 2 1 0 7 6 W, zotëruese e 1 (një) kuote, 100 % (njëqind përqind) të kapitalit dhe në vlerën prej 100.000 (njëqind mijë) Lekë.

- 7.2 Kontributi i ortakut të vetëm do të jetë në para.
- 7.3 Oraku I vetëm I shoqërisë përgjigjet për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e tij në kapitalin e saj.



# AKT THEMELIMI STATUT I SHOQËRISË

“Proservis” sh.p.k.

---

## Neni 8

### **Kuota. Fitimi, Transferimi i kuotës**

- 8.1 Kuota e kapitalit të shoqërisë mund të fitohet nëpërmjet kontributit në kapitalin e shoqërisë, shit-blerjes, trashëgimisë, dhurimit apo çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
- 8.2 Në rastin e kalimit të kuotës me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
- 8.3 Ky statut nuk kushtëzon kalimin e kuotës të tretëve jashtë shoqërisë me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë, sipas modaliteteve dhe shumicës së kualifikuar që kërkon ndryshimi i statutit.
- 8.4 Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotës, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në QKB, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. Regjistrimi i kalimit të kuotës ka efekt deklarativ.
- 8.5 Kuota e kapitalit themeltar është lirisht e transferueshme me rrugë trashëgimie.

## Neni 9

### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme (Ortakut të vetëm) mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotën e ortakut të vetëm në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakëve të rinj, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme (Ortakut të vetëm).
- 9.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të vetëm).


## KREU III

### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

## Neni 10

### **Organi Vendimmarrës**

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme (Ortakut të vetëm) është organi i vetëm vendimmarrës që miraton çdo ndryshim sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.



# AKT THEMELIMI STATUT I SHOQËRISË

“Proservis” sh.p.k.

---

- 10.2 Asambleja e Përgjithshme (Ortakut të vetëm) është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e sipër përmendur në shkronjat “c” dhe “ç”;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotës dhe anulimin e saj;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj adinistratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

## Neni 11

### Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të vetëm)


- 11.1 Asambleja e Përgjithshme (Ortakut të vetëm) thirret nga Administratori nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose nëpërmjet e-mail. Njoftimi me shkresë apo me postë elektronike duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes, rendin e ditës, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

## KREU IV ADMINISTRATORI

### Neni 12

#### Administrimi i shoqërisë

- 12.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme (Ortakut të vetëm).



4

# AKT THEMELIMI STATUT I SHOQËRISË

“Proservis” sh.p.k.

---

Administrator I shoqërise do të jetë **Monika Majko**, atësia Rasim, e lindur më datë 21/12/1972, me zotesi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtese e letërnjoftimit me nr. 036870648 dhe me nr. Personal H26221076W, banuese në Tiranë.

Afati i ushtrimit të detyrës është 5 (vjet) vjet me të drejtë ripërtëritje.

## Neni 13


### Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit. Përgjegjësitë

- 13.1 Administratori **Monika Majko** ushtron kompetencat e mëposhtme:
- 13.1.1 Kryen të gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme (Ortakut të vetëm);
  - 13.1.2 Kryen emërimin dhe shkarkimin nga puna të punëmarrësve të shoqërisë;
  - 13.1.3 Jep urdhra dhe udhëzime punëmarrësve dhe vendos sanksione ndaj tyre, në përputhje me kontratat e punës dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë;
  - 13.1.4 Drejton dhe organizon punën në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e shoqërise në veprimtarisë e saj ekonomiko-financiare;
  - 13.1.5 Të zbatojë vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme (Ortakut të vetëm);
  - 13.1.6 T’i paraqesë në mënyrë të rregullt dhe në kohë të përshtatshme Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të vetëm), raportin e administrimit, inventarit, bilancin dhe llogaritë vjetore si dhe të përgjigjet për to.
  - 13.1.7 Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj te tretëve, për shkelje të ligjit dhe statutit dhe për faje të kryera gjatë administrimit sipas parashikimit të Ligjit nr. 9901, “Për tregtarët dhe shoqërite tregtare” dhe ligjeve të tjera në fuqi.

## Neni 14

### Mbarimi i mandatit të Administratorit

- 14.1 Mandati i Administratorit përfundon:
- me mbarimin e afatit;
  - me shkarkimin e tij nga Asambleja e Përgjithshme (Ortakut të vetëm);
  - kur vetë Administratori jep dorëheqjen vullnetarisht;
  - sipas mënyrave të tjera parashikuar nga Ligji nr. 9901 dt. 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare



# AKT THEMELIMI STATUT I SHOQËRISË

“Proservis” sh.p.k.

---

## Neni 15

### Viti Financiar

- 15.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më datë 1 Janar dhe përfundon më datë 31 Dhjetor. Përgjithësisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

## Neni 16

### Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

- 16.1 Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme (Ortakut të vetëm), miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.
- 16.2 Shoqëria mund t'i shpërndajë fitime ortakut të vetëm, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
  - shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
- 16.3 Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e paragrafit 2 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administrator nuk mund ta lëshojë këtë certifikatë.

## Neni 17

### Ekspertët

- 17.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko - tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut të vetëm.
- 17.2 Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultalit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut të vetëm për t' i shqyrtuar e miratuar.



# AKT THEMELIMI STATUT I SHOQËRISË

“Proservis” sh.p.k.

---

## Neni 18

### Shpërndarja ose prishja e shoqërisë

- 18.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:
- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të vetëm);
  - me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit nr. 9723, data 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
  - me vendim të gjykatës.
- 18.2 Në këtë rast, Ortaku i vetëm merr vendim me shkrim, ku parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1/disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuiduesit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.
- 18.3 Prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.
- 18.4 Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë nenet 191 deri në 203 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- 18.5 Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar në përputhje me nenet 204 dhe 205 të Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

## Neni 19


### Baza Ligjore

- 19.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 19.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbalohen dispozitat e Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”; Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 20

### Mosmarrëveshjet

- 20.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të



7

AKT THEMELIMI STATUT I SHOQËRISË

“Proservis” sh.p.k.

---

jenë kompetente gjykatat shqiptare, sipas Kodit të Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**

**Dispozita e fundit**

- 21.1 Statuti hyn në fuqi me regjistrimin e tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 21.2 Statuti redaktohet në gjuhën shqipe, miratohet e nënshkruhet nga Ortaku I vetëm themelues i shoqërisë “Proservis”.

**ORTAKU I VETËM THEMELUES**

**Monika Majko**

*Monika R. Majko*

*[Signature]*